

VENDIM
Nr. 213, datë 20.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM MIDIS ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (ERE) DHE ZYRËS SË
RREGULLATORIT PËR ENERGJINË (ZRRE) TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 18 dhe nenit 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 116/2 prot., datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore, në lidhje me miratimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim midis Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) të Republikës së Kosovës,

konstatoi se:

- bashkëpunimi, midis Entit Rregullator të Energjisë, të Republikës së Shqipërisë (ERE) dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë, të Republikës së Kosovës (ZRRE), krijon avantazhe dypalëshe në funksion të ndërveprimit mes entiteteve, me qëllim përmbushjen e misionit të tyre;
- palët shohin një mundësi për të përqendruar përpjekjet e tyre të përbashkëta, në zhvillimin e një kornize të qëndrueshme rregullatore, në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, si në nivel rajonal, ashtu dhe në atë dypalësh;
- nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim, do të shërbejë si një kornizë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë në kuadër të *Western Balkan 6* për shkëmbimin e informacionit mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella.

VENDOSI:

1. Të miratojë Marrëveshjen për Bashkëpunim midis Entit Rregullator të Energjisë (ERE), të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë (ZRRE), të Republikës së Kosovës. (Marrëveshja përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Kryetari i ERE-s nënshkruan këtë Marrëveshje për Bashkëpunim.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Entit Rregullator të Energjisë për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM
MIDIS
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (ERE)
DHE
ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJINË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (ZRRE)

Zyra e Rregullatorit për Energjinë dhe Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë palët), shohin avantazhin e forcimit të veprimit sienergjik, po ashtu përmes bashkëpunimit dypalësh. Në mënyrë të veçantë palët shohin mundësinë për të përqendruar përpjekjen e tyre të përbashkëta mbi zhvillimin e një strukture të qëndrueshme rregullatore në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit në nivel rajonal dhe në nivel dypalësh,

duke marrë parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim si një strukturë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimin e informacionit mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella,

palët ranë dakord për të bashkëpunuar si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë mbi baza dypalëshe dhe shumëpalëshe për të harmonizuar kornizat rregullatore dhe për të promovuar zhvillimin dhe integrimin e tregjeve.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë për të favorizuar aktivitetet e përbashkëta të përqendruara në iniciativat e ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, seminare të posaçme (*ad hoc*), *workshop*-e dhe trajnime.

Neni 3

Palët duhet të shkëmbejnë eksperiencat në zbatimin e analizës ekonomike dhe juridike të procedurave për përcaktimin e të ardhurave rregullatore të lejuara dhe çmimet e ndërmarrjeve të rregulluara.

Neni 4

Palët në Marrëveshje nuk do të vënë në dispozicion ose nuk do t'u japin palëve të treta asnjë informacion që ata kanë shkëmbyer me njëri-tjetrin pa miratimin paraprak të nënshkruesit të Marrëveshjes.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë dhe/ose ndikojë te të drejtat dhe detyrimet e nënshkruesve të Marrëveshjes, të drejta që rrjedhin nga memorandume të tjera ndërkombëtare te të cilat marrin pjesë.

Neni 6

Palët mund të caktojnë nëpunës, që të zbatojnë Marrëveshjen, si persona kontakti për çdo aktivitet në të ardhmen, bazuar te kjo marrëveshje.

Neni 7

Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë të pakufizuar.

Marrëveshja mund të ndërpritet nga secila palë duke paraqitur një njoftim me shkrim për palën tjetër.

Neni 8

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE-s.

Nënshkruar në Prishtinë, Kosovë,
në datën __ dhjetor 2019.

Për ERE-n:

Petrit Ahmeti,
KRYETAR I BORDIT

Për ZRRE-në:

Arsim Janova,
UD KRYESUES I BORDIT